



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 27.01.2023

Nr. 20

Ora 11:30

V E N D I M

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR VJETOR TË PARTIVE POLITIKE,
VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE, SI DHE PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
PAGESËS SË AUDITUESVE LIGJORË

Në mbështetje të neneve 15/2, pika 2, shkronja “a”, 23, 23/1, 23/2, 23/3, 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, miratimin e modelit të dokumentacionit që do të përdoret me këtë rast, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë.

Neni 2

Raporti financiar vjetor i partisë politike

1. Raporti financiar vjetor i partisë politike përmban informacion të hollësishëm për:
 - a) burimet e financimit;
 - b) shpenzimet;

Data: 27.01.2023 Nr. 20
Ora 11:30



“Për miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë”

- c) subjektet e lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre, të cilat deklarohen nga vetë partia politike.
2. Raporti financiar vjetor përfshin periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti.
 3. Raporti financiar vjetor hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ-03-02, shtojca nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 3

Dorëzimi i raportit financiar vjetor

1. Partia politike ka detyrimin të dorëzojë në KQZ raportin financiar vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Raporti financiar duhet të jetë i firmosur nga kryetari i partisë politike ose nga personi i autorizuar nga ky i fundit dhe nga financieri i partisë.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson partive politike dorëzimin e raporteve financiare vjetore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, www.kqz.gov.al.
3. Plotësimi dhe dorëzimi i raportit financiar vjetor nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar bëhet sipas procedurave të parashikuara në rregulloren përkatëse të miratuara nga KQZ-ja.
4. Raporti financiar vjetor publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit të tij në KQZ.

Neni 4

Raporti financiar vjetor i një viti zgjedhor

1. Raporti financiar vjetor i një viti përgjatë të cilit janë zhvilluar zgjedhje për Kuvendin ose për Organet e Qeverisjes Vendore përmban krahas të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit, apo të dhëna të tjera mbi to, edhe të ardhurat dhe shpenzimet e partisë sipas raportit financiar të fushatës zgjedhore. Në këtë rast të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet si për fushatën zgjedhore, ashtu edhe ato vjetore pasqyrohen të integruara në raportin financiar vjetor me përshkrimet përkatëse.
2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, në çdo rast raporti financiar për zgjedhjet duhet të dorëzohet i veçantë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së.

Neni 5

Vlerësimi *prima facie* i raportit financiar vjetor nga KQZ-ja

1. Jo më vonë se 10 ditë pune nga data e dorëzimit të raportit vjetor financiar në KQZ administrata e saj bën verifikimin *prima facie* duke:
 - a) verifikuar elementet formale sipas modelit KQZ-03-02, shtojca nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet sipas modelit KQZ-04-05, shtojca nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim.
2. Nëse nga verifikimi i raportit financiar vjetor, i bërë sipas pikës 1 të këtij neni, rezultojnë mangësi, atëherë KQZ-ja ia kthen raportin partisë për plotësim. Jo më vonë se 5 ditë nga data e kthimit për plotësim partia ka detyrim të ridërgojë në KQZ raportin me plotësimet e kërkuara së bashku me shpjegimet kur është rasti
3. KQZ-ja publikon raportin sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 3 të këtij akti.

Neni 6

Auditimi i raportit financiar vjetor

1. Auditimi i raportit financiar vjetor kryhet nga ekspertë kontabël të licencuar, të cilët nga këtu e në vijim në këtë akt referohen si “auditues ligjorë”. Audituesit ligjorë caktohen nga KQZ-ja sipas procedurave të përcaktuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Audituesi ligjor auditon raportin financiar vjetor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së tij prej KQZ-së, ose sipas rastit nga momenti i nënshkrimit të kontratës me KQZ-në. Auditimi kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet e auditimit financiar të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
3. Audituesi ligjor ka të drejtë:
 - a) të intervistojë persona dhe subjekte të ndryshme;
 - b) të marrë informacion nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c) të këqyrë dokumente që lidhen me këto verifikime të thelluara pranë zyrave përkatëse të partisë politike;

- d) të marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë.
4. Në përfundim të auditimit, audituesi ligjor i dorëzon partisë politike dhe KQZ-së projektraportin e auditimit, i cili përmban gjetje dhe rekomandime përkatëse sipas modelit KQZ-03-07, shtojca nr. 4 bashkëlidhur këtij vendimi. Nëse për arsye të përligjura audituesi nuk dorëzon në KQZ projektraportin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, KQZ-ja mundet ta shtyjë afatin e dorëzimit të tij deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe për jo më shumë se dy herë.
 5. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja në dorëzim e projektraportit të auditimit, partia politike ka të drejtën t'i paraqesë audituesit dhe KQZ-së shpjegime (kundërshtime) në lidhje me projektraportin.
 6. Audituesi ligjor, pasi merr shpjegimet nga partia politike, i shqyrton ato dhe në rast se i vlerëson të arsyeshme, ndryshon ose plotëson pjesët përkatëse të raportit të auditimit duke i pasqyruar ato në raportin përfundimtar.
 7. Audituesi ligjor i dorëzon partisë politike dhe KQZ-së raportin përfundimtar të auditimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së shpjegimeve nga partia politike. Raporti përfundimtar hartohet sipas modelit KQZ-03-01, shtojca nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi.
 8. Nëse raporti financiar vjetor i partisë është paraqitur në KQZ nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar, audituesi bën vlerësimet për raportin po nëpërmjet kësaj platforme në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga KQZ.

Neni 7

Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare vjetore të partive politike dhe krahasimet me raportet e auditimit

1. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të auditimit në KQZ, administrata e KQZ-së bën vlerësimin e integruar nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave të këtij raporti me ato të raportit vjetor financiar të dorëzuara nga partia duke:
 - a) krahasuar të dhënat me gjetjet dhe konkluzionet në raportin e audituesit ligjor, i përzgjedhur nga KQZ-ja për të audituar raportin financiar vjetor, si dhe çdo informacion të marrë gjatë hetimit administrativ si rezultat i ankesave, kërkesave apo denoncimeve lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar;

- b) kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
 - c) kontrolluar nëse janë deklaruar në raportin financiar vjetor fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike për qëllime jozgjedhore.
2. Në përfundim të verifikimit, nga kryqëzimi i të dhënave nga raporti vjetor financiar dhe raporti përfundimtar i auditimit, dhe informacione të tjera të administruara, administrata e KQZ-së harton raportin e gjetjeve dhe ia dorëzon Komisionerit.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikon raportet e auditimit për partitë politike brenda 30 ditëve nga koha e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit.

Neni 8

Financieri apo personi përgjegjës për financat e partisë politike dhe përgjegjësitë

1. Të gjitha partitë politike të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë duhet të caktojnë një financier apo person përgjegjës për raportimin financiar vjetor, sipas statutit të partisë politike.
2. Partia politike ndërpret marrëdhëniet me financierin dhe emëron një financier të ri në rastet kur financieri:
- a) bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
 - b) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
 - c) jep dorëheqjen;
 - d) është në kushtet e konfliktit të interesave në raport me KQZ-në;
 - e) vdes.
3. Financieri i partisë politike apo personi përgjegjës, sipas statutit të partisë politike, mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij duke:
- a) administruar veprimtarinë vjetore të partisë politike;
 - b) regjistruar të gjitha transaksionet financiare, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë;
 - c) mbledhur dhe arkivuar/ruajtur të gjithë informacionin dhe dokumentet mbështetëse përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet

vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve. Regjistri i dhurimeve mbahet sipas modelit KQZ-02-06, shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi;

d) dorëzuar raportin financiar vjetor e duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;

e) siguruar që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga audituesi ligjor apo KQZ-ja.

4. Personi përgjegjës për financat në parti në politike brenda 3 (tre) muajve nga krijimi i partisë politike deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare të hapur për dhurimin e fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 (njëqind) mijë lekë. Numri i llogarisë bankare për çdo parti politike publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 9

Mënyra e pagesës së audituesve ligjorë

1. Shpenzimet e nevojshme për auditimin e partive politike për vitin kalendarik mbulohen nga vetë partitë politike.
2. Partive politike që përfitojnë fonde nga KQZ-ja dhe nuk e shlyejnë detyrimin sipas pikës 1 të këtij neni, do t'u mbahet ky detyrim në momentin e shpërndarjes së fondeve vjetore të vitit pasardhës.
3. Partitë politike, të cilat nuk përfitojnë fonde nga KQZ-ja, duhet të transferojnë fondet e nevojshme në llogarinë bankare të KQZ-së me qëllim pagesën e audituesve ligjorë. Afati për transferimin e këtyre fondeve duhet të jetë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dorëzimi i afatit përfundimtar të raportit të auditimit vjetor në KQZ.

Neni 10

Sanksionet

Shkelja e dispozitave të këtij vendimi ndëshkohet sipas neneve 23/4 dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar.

Neni 11
Dispozita të përkohshme dhe shfuqizime

1. Rregullat për raportimin financiar vjetor nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF) hyjnë në fuqi me vendim të veçantë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Udhëzimi nr. 10, datë 21.04.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”, si dhe vendimi nr. 3, datë 18.01.2012, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e rregullave dhe formateve të standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël” shfuqizohen.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i shtrin efektet ligjore për raportimin vjetor të vitit 2023.

Neni 13
Ankimi

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Shtojca 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike	
Shkronjat Nistore	
Numri i vendimit të rregjistrimit në Gjykatë	
Data e vendimit të rregjistrimit në Gjykatë	
Kryetari i Partisë Politike	
Tel/Cel	
Email	
NIPT	
Adresa	

Emri i Financierit	Mbiemri i Financierit	Nënshkrimi

Tel/Cel i Financierit	Email i Financierit	NID i Financierit

Emri i Aprovuesit	Mbiemri i Aprovuesit	Nënshkrimi

Data e dorëzimit të Raportit

- 1.Pozicioni Financiar
 - 1.1 Asetet
 - 1.2 Detyrimet
- 2.Detaje Përmbledhje
- 3.a Të ardhura - Financime publike
- 3.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 3.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
- 3.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike
4. Huatë dhe Kreditë
5. Shpenzimet e partisë
 - 5.a Raportet sipas degëve

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.

Tabela "Referenca" nuk ka nevojë të plotësohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN _____

Emri i Partisë Politike

Shkroniat Nistore

1. Pasqyra e pozicionit financira për periudhë

Nr	AKTIVET	Periudha Raportuese	Periudha Pararendëse
1	Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre		
2	Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		
3	Kontribute të arkëtueshme		
4	Inventar dhe shpenzime të parapaguara		
I	Shuma		
A	Investime financiare afat gjata		
1	Ndertesa		
2	Paisje zyre, Informatike		
3	Mjete transporti		
4	Investime të tjera afat gjata		
II	Shuma		
	Totali Aktiveve		
	DETYRIMET		
A	Të pagueshme		
1	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore		
2	Dëftesa të pagueshme (ndaj të treqeve)		
3	Kontribute të marra në avancë		
4	Te tjera (Detyrime tatimore, tatim qera)		
I	Shuma		
B	Grante		
1	Grantet, Donacionet, Subvencionet		
2	Kredi/Hua afatgjate		
	Shuma		
	Totali Detyrimeve		
	AKTIVET NETO (Aktiv-Pasiv)		
A	Të kufizuara		
	a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
	b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
B	Të pakufizuara		
	Totali Aktiveve Neto		

FINANCIERI

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

0

Shkronjat Nistore

0

1.1 Asetet

Nr.	EMERTIMI	Gjendje në fillim të vitit ushtrimor	Shtesa gjate vitit ushtrimor				Pakesime gjate vitit ushtrimor				Gjendja në mbyllje të vitit ushtrimor
			Blerje e krijuar me pagese	Asete të dhëna në përdorim	Asete të dhuruara	Totali i shtesave gjatë vitit	Shitje	Nx.jashtë përdorimit	Pakësime të tjera	Totali	
1	I. AAGJ / JOMATERIALE										
3	Aktive të ndryshme/jo materiale										
4											
5	II. AAGJ / MATERIALE										
6	Ndertesa										
8	Paisje zyre, Informatike										
10	Mjete transporti										
11	Investime të tjera afat gjata										
19											

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

1.2 Detyrimet gjatë vitit ushtrimor

Nr.	EMERTIMI	Gjendje në fillim të vitit ushtrimor	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Gjendja në mbyllje të vitit ushtrimor
1					
1	Te pagueshme				
1,1	Të pagueshme për furnizime dhe shërbime				
1,2	Të pagueshme për kontribute për punonjësit				
1,3	Shteti/tatim taksa/tatim në burim				
2	Dëftesa të pagueshme (ndaj te treteve)				
3	Kontribute të marra në avancë				
4	Paisje zyre, Informatike				
5	Mjete transporti				
6	Investime të tjera afat gjata				
1	Grantet, Donacionet, Subvencionet				
2	Kredi/Hua afatgjate				

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

Pjesa A - Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
a. Totali i të ardhurave nga fondet publike	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike/juridik	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga degët e partisë	ALL	-
d. Totali i të ardhurave të krijuara nga vetë partia	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i shpenzimeve të bëra nga partia	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve të bëra nga degët e partisë	ALL	-
c. Totali i shpenzimeve indirekte/ Dhurimet ne natyre	ALL	-
d. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

Pjesa B - Deklarata

Duke qenë i/e vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme, në bazë të njohurive të mia më të mira dhe me përgjegjësi për përgatitjen e këtij raporti, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

3.a Të ardhura - Financime publike

Shuma e fondeve publike të përfituara në përputhje me nenin 19, të ligjit për partitë politike dhe me nenet 88 dhe 89 të Kodit Zgjedhor

a Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit (sipas nenit 19 të ligjit për partitë politike + sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor nëse ka qenë vit zgjedhor)

Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit

FINANCIERI

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

3.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

A. Statusi i dhuruesit B. Emri i dhuruesit C. Mbiemri i dhuruesit D. Adresa (rreshti 1) E. Adresa (rreshti 2) F. Kodi postar i adreses G. Numri i identifikimit H. Shuma e dhurimit I. Data e dhurimit J. Dhurim për fushatë/vit K. Metoda e dhurimit L. Kodi bankar i llogarisë në të cilën u depozitua dhurimi M. Numri i llogarisë në të cilën u depozitua dhurimi N. Marrë në dorëzim nga: O. Emri i degës

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

3.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

A. Statusi i dhuruesit

B. Emri i dhuruesit

C. Mbiemri i dhuruesit

D. Adresa (rreshti 1)

E. Adresa (rreshti 2)

F. Kodi postar i adreses

G. Numri i identifikimit

H. Vlera e dhurimit

I. Data e dhurimit

J. Dhurime fushatë/vit

K. Marrë në dorëzim nga:

L. Emri i degës

M. Përshkrimi i dhurimit në natyrë

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

3.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike

A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura

B. Shuma e të ardhurave

C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat

D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

F. Të ardhura të krijuara për fushatë/vit

G. Emri i degës (nëse është i aplikueshëm)

H. Përshkrimi/ Emri i dhuruesit

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

4. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4. Huatë dhe Kreditë

Termat

A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kredisë	H. Shuma e huasë/limiti i kredisë	I. Data e fillimit të huasë/kredisë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolaterali i ofruar
-----------------------	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------	--	--	-----------------------------------	-------------------------------------	----------------------	---------------------	------------------------

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë
Politike

Shkronjat Nistore

5. Shpenzimet e partisë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni
gjë për të raportuar 5. Shpenzimet e
partisë

Shpenzime
sipas
degëve

Mitingje/ Kongrese/

Media

Materiale
promocionale/Medi
a
Sociale/Sondazhe/P
S. Përshkrimi

A. Kategoria e shpenzimeve	B. Shitësi/furni zuesi	C. Nr identifikimit të faturës	D. Data e faturës	E. Data e pagesës	F. Shuma e paguar	G. Shuma e papaguar (nëse ka)	H. Metoda e kryerjes së pagesës	I. Shpjegimi	J. Shpenzimi i kryer për fushatë/vit	L. Sipas bashkive	M. Vendi i mitingut/kongresi	N. Ambienti	O. Data e mitingut/kongresi	Minutazhi Kontrata
----------------------------	------------------------	--------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------------------	---------------------------------	--------------	--------------------------------------	-------------------	------------------------------	-------------	-----------------------------	--------------------

FINANCIERI

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shëronjat Nistore

5.a Raportet sipas degëve

Ju lutemi konfirmoni nëse keni gjetë për të raportuar 5.a Raportet sipas degëve

- A. Bashkia B. Të ardhurat totale sipas secilës degë C. Shpenzimet totale sipas secilës degë

- Belsh
- Berat
- Bulqizë
- Cërrik
- Delvinë
- Devoll
- Dibër
- Divjakë
- Dropull
- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Finiq
- Fushë Arëz
- Gjirokastrë
- Gramsh
- Has
- Himarë
- Kamëz
- Kavajë
- Këlcyrë
- Kos
- Kolonjë
- Konispol
- Korçë
- Krujë
- Kuçovë
- Kukës
- Kurbin
- Lezhë
- Libohovë
- Librazhd
- Lushnjë
- Malësi e Madhe
- Maliq
- Mallakastrë
- Mat
- Memaliaj
- Mirditë
- Patos
- Pegon
- Përmet
- Pogradec
- Polican
- Prronjas
- Pukë
- Pustec
- Roskovec
- Rrogozhinë
- Sarandë
- Selenicë
- Shijak
- Shkodër
- Skrapar
- Tepelenë
- Tiranë
- Tropojë
- Ura Vajgurore
- Vau i Dejës
- Vlorë
- Vorë

FINANCIERI

Emër Mbledhës Firmë

APROVUESI

Emër Mbledhës Firmë

Sherbime nga te tretet

Shpenzim pagese gjobe
 Shpenzime për pagat e
 personelit
 Shpenzim per pages interesi
 ne rast kredie
 Shpenzime sig shoqerore
 dhe shendetsore
 Amortizimi
 Shpenzime zyre

Shpenzime administrative

Krijim dhe rritje fondesh
 Shpenzime vetem per
 fushate

Total veprimtaria politike
 (Zgjedhjet/të korespondoj
 me totalin e shumës së
 raportuar për fushatë)

said

- Lushnjë
- Malësi e Madl
- Maliq
- Mallakastër
- Mat
- Memaliaj
- Mirditë
- Patos
- Peqin
- Përmet
- Pogradec
- Polican
- Prrerjas
- Pukë
- Pustec
- Roskovec
- Rrogozhinë
- Sarandë
- Selenicë
- Shijak
- Shkodër
- Skrapar
- Tepelenë
- Tiranë
- Tropojë
- Dimal (Ura
Vajgurore)
- Vau i Dejës
- Vlorë
- Vorë
- Këlcyrë
- Finiq
- Konispol
- Himare
- Korce
- Kolonje
- Devoll
- Elbasan
- Gramsh
- Klos
- Fushë Arrëz
- Has
- Kamëz
- Krujë
- Kavajë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË E DHURIMIT PËR PARTINË POLITIKE _____

Për vitin kalendarik _____

Data e dhurimit _____

I) TË DHËNAT E
DEKLARUESIT

1. _____ (Emër, Atësi, Mbiemër)	2. Datëlindja _____ dd/mm/vvvv
3. Adresa _____	4. Tel/Cel _____
5. Email _____	
6. Person Fizik/Juridik _____	7. NIPT _____ (nëse je person juridik)

II) TË DHËNAT E
DHURIMIT

1. Dhurim në natyrë _____	2. Lloji i dhurmit _____
1. Dhurim në monedhë _____	
2. Vlera e dhurmit _____ (cash) (bank) (çek bankar)	

DEKLAROJ

Nën përgjegjësinë time personale se jam në dijeni të nenit 23/1, pika 1, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklarim të rremë.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)



Modeli KQZ-02-06

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

REGJISTRI I DHURIMEVE

Për vitin kalendarik _____

NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NË LEKË	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	NIPTI	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURIMI
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
SHUMA TOTALE E DHURUAR Shifër (fjalë) lekë						

Shënim: Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, partia politike do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, partitë politike do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Partia Politike _____, Financieri/personi përgjegjës sipas statutit të partisë politike _____

(emër, mbiemer)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROJEKT RAPORT PËR PARTINË POLITIKE _____ PËR VITIN KALENDARIK _____

I) TË DHËNAT E
AUDITUESIT

- | | |
|------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. _____
(Emër, Atësi, Mbiemër) | 2. Datëlindja _____
dd/mm/vvvv |
| 3. Adresa _____ | 4. Tel/Cel _____ |
| 5. Email _____ | |
| 6. Nr. Vendimi _____ | 7. Datë vendimi _____ |

I) TË DHËNAT E
PARTISË POLITIKE

- | | |
|--------------------------------------|--|
| 1. Partia Politike _____ | 2. Shkronjat nistore _____ |
| 3. Kryetari _____
(Emër, Mbiemër) | 4. Selia _____ |
| 5. NIPT _____ | 6. Financieri _____
(Emër, Mbiemër) |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHEJVE

I. TË DHËNAT E LLOGARARISË BANKARE TË PARTISË POLITIKE

Emri i bankës	
Adresa e zyrës së bankës	
Numri i telefonit të zyrës së bankës	
Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	
Numri i llogarisë bankare	
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHEJVE

A. AKTIVET DHE DETYRIMET

1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve	
	Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit
	Përshkruani vendndodhjen e aktivitetit
	Shkruani vlerën e tregut të aktivitetit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur
2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve	
	Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit
	Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet
	Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHEJVE

B. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare		
	Periudha e raportimit (data e fillimit dhe e përfundimit të periudhës që mbulon raportin)	
	Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit	
